



Miratohet akti normativ "Për disa shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar"



Objekti i këtij akti normativ, i propozuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën, është përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat për shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë pension, si kusht lehtësues për vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përmes zbatimit të tij, do të krijohet hapësirë dhe mundësi që shtetasit e huaj dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të zgjedhin Shqipërinë si vendbanimin e tyre pas daljes në pension si dhe do të ndikojë në forcimin e lidhjeve të shqiptarëve në Diasporë me vendin e tyre të origjinës. Akti normativ parashikon strukturat e organeve tatimore si përgjegjëse për garantimin për trajtim të barabartë të subjekteve përfituese dhe është në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Diasporën.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Drejtoresha ekzekutive e AKD-së në aktivitetin e "ANIAS"



Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Elona Bano, mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga shoqata e rrjetit italo-shqiptar "ANIAS" në Romë, me temë "100 vjet parlamentarizëm shqiptar dhe nxitja e investimeve në Shqipëri". Aktiviteti filloi me një vizitë në Senatin Italian, ku u takuan me eurodeputetin Simona Baldassarre, dhe u vijua me zhvillimin e një konference me pjesëmarrjen e drejtoreshës së Agjencisë; deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Tatiana Piro dhe z. Bujar Çela; si edhe përfaqësues të fushës ekonomike dhe sociale të shtetit Italian. Gjatë fjalës së saj përshëndetëse, znj. Bano prezantoi politikën shtetërore për Diasporën, veprimtarinë e Agjencisë dhe ecurinë mbi zbatimin e masave të Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Ajo theksoi se Strategjia synon afrimin e Diasporës shqiptare me vendin e origjinës si dhe angazhimin e saj në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Më tej, si nxitje për rrjetëzimin e sipërmarrësve të Diasporës, ajo përmendi Samitin e Grave të Biznesit, i organizuar pak ditë më parë në Tiranë si dhe Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare, e cila synon nxitjen e kapitalit investues dhe krijimin e një klime pozitive në ekonominë mbarëshqiptare.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës merr pjesë në mbledhjen e I-rë, si anëtar i Këshillit të Investimeve



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i përfaqësuar nga drejtoresha ekzekutive znj. Blerina Turdu dhe Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare, e përfaqësuar nga znj. Soana Jaupllari, morën pjesë në mbledhjen e radhës dhe të parën për këtë vit të Këshillit të Investimeve. Dy institucionet, janë bërë anëtarë të Këshillit të Investimeve me Vendim të Këshillit të Ministrave, në fund të vitit që lamë pas. Gjatë kësaj mbledhje, u theksua rëndësia e ndërveprimit bashki-biznes për rritjen e transparencës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj dhe ministri për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Eduard Shalsi, u vu në dukje progresi i shënuar nga zbatimi i reformës administrative-territoriale. Këshilli i Investimeve ka realizuar në vitin 2019 një anketim në të gjithë Shqipërinë për bashkëveprimin e sipërmarrësve me pushtetin vendor. Gjithashtu, gjatë kësaj mbledhjeje u diskutuan edhe çështje të tjera të rëndësishme nga të pranishmit.

Parlamenti grek ratifikoi marrëveshjen për patentat



Parlamenti grek ratifikoi marrëveshjen për njohjen e ndërsjellë të patentave mes Shqipërisë dhe Greqisë. Sipas kësaj marrëveshjeje, të gjithë shtetasit shqiptarë që udhëtojnë drejt vendit fqinj mund të drejtojnë automjetin e tyre pa pasur nevojë të pajisen me leje drejtimi ndërkombëtar. Marrëveshja parashikon që në momentin që shtetasit shqiptarë marrin qëndrim në Greqi, mund t'i konvertojnë patentat e tyre shqiptare në patenta greke pa pasur nevojë kryerjen e testeve teorike dhe praktike.

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmetet



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

KKD / Lazim Destani pjesë e aktiviteve në kujtim të presidentit Rugova

Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe President Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës shqiptare, Lazim Destani mori pjesë në ceremoninë e hapjes së ekspozitës me titull "Kontributi i Presidentit Historik Dr. Ibrahim Rugova në Shtet-formimin e Kosovës" në Berlin të Gjermanisë. Ky aktivitet është organizuar në nderim të figurës dhe punës së Presidentit Rugova, në përkujtimin e 14-vjetorit të vdekjes së tij. Destani, përmes një publikimi në "Facebook", ka shkruar për rëndësinë e organizimit të kësaj ngjarjeje në kujtim të vepërës së presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, dhe mbi të gjitha, tënjeriut që bëri aq shumë për Pavarësinë e Kosovës.



Aktiviteti i AKD-së në Selanik të Greqisë



Në Selanik u zhvillua koncerti me artistët e mirënjohur shqiptarë Inva Mula, Olen Cezari dhe Genc Tukiçi, organizuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

KKD / Mark Gjonaj vizitë në federatën mbarëshqiptare "Vatra"



Kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe këshilltar i Bashkisë së Nju-Jorkut, Mark Gjonaj zhvilloi një vizitë në federatën mbarëshqiptare "Vatra" në SHBA, ku uroi kryetarin Elmi Berisha për detyrën e tij të re. Sipas njoffimit të federatës "Vatra", Gjonaj vlerësoi dhe kontributin e kësaj federate si një faktor të rëndësishëm në bashkimin e komunitetit dhe promovimin e vlerave të kombit shqiptar. "Vatra është një faktor historik dhe aktual i komunitetit dhe të gjithë ndjehemi krenarë për moshën dhe veprat e saj për komunitetin dhe Kombin shqiptar. ...Sa më e fortë të jetë Vatra, sa më e bashkuar, sa më aktive të jetë ajo, aq më i fortë dhe më aktiv është komuniteti shqiptar në Nju-Jork e në SHBA", ka thënë Gjonaj.

KKD / Sokrat Sinaj, takim me komunitetin shqiptar në Zvicër

Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Sokrat Sinaj, mori pjesë në takim me përfaqësues të shoqatave dhe komunitetit shqiptar në Bern të Zvicrës, me qëllim angazhimin e Diasporës në organizimin e ndihmave për familjet e dëmtuara nga tërmeti. Sinaj, gjatë këtij takimi është ndalur dhe në prezantimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, i krijuar në fund të vitit të kaluar për të nxitur kapitalin investues të Diasporës në vendin e origjinës. Në takim morën pjesë edhe ambasadorët e Shqipërisë dhe Kosovës në Zvicër, z. Ilir Gjoni dhe znj. Nazane Breca.



KKD / Namik Shabi, takim me ambasadorin e ri të Republikës së Shqipërisë në Turqi

Anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht anëtar i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, Namik Shabi gjatë një takimi me ambasadorin e ri të Republikës së Shqipërisë në Ankara, Kastriot Robo ku biseduan për komunitetin shqiptar, atje.

